

Duke njojur njëra tjetrën si institucion e pavarur, të themeluara me ligj, me misione dhe qëllime të ndryshme, Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Oda e Avokatëve të Kosovës pajtohen që të hyjnë në këtë:

Memorandum të Mirëkuptimit

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MiM) është themelimi i bashkëpunimit në mes të Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK) dhe Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), përmundësimin e shkëmbimit të kapaciteteve profesionale dhe praktikave më të mira të ndërsjella.

Neni 2 Obligimet e palëve

- 2.1** IGJK dhe OAK (tani e tutje palët), zotohen se do të shkëmbejnë materiale të ndryshme trajnuese dhe praktikave më të mira të cilat konsiderohen të nevojshme përmirësuar nga ngritjen profesionale të trajnuesve dhe përfituesve të seilit institucion, duke ruajtur të drejtën që të mbajnë përmirësuar vete materialet e rezervuara apo të klasifikuara. Palët ruajnë të drejtën e autorësisë së materialeve të shkëmbyera.
- 2.2** Palët obligohen t'i përdorin materialet e marra nga njëra tjetra siç është paraparë në këtë memorandum. Palët mund t'i përshtatin këto materiale sipas nevojave dhe specifikave të tyre, por pa prekur në të drejtën e autorësisë.
- 2.3** Palët do të shkëmbejnë me njëra tjetrën listën e trajnuesve dhe temat në të cilat ata trajnues mbajnë trajnime, me qëllim të realizimit të trajnimeve sa më profesionale.
- 2.4** Palët angazhohen që publikimet e tyre të dërgohen reciprokisht në mënyrë periodike.

Neni 3
Trajnimet

- 3.1** Palët mund të akreditojnë programet përkatëse trajnuese të njëra tjetrës nëse kategoritë e njërsë palë marrin pjesë në trajnimet e vazhdueshme të organizuara nga pala tjetër.
- 3.2** Në rastet nga paragrafi 1 i këtij nenit, palët duhet të pranojnë kreditë e fituara nga pjesëmarrësit dhe të njëjtat t'i regjistrojnë në dosjet e tyre përkatëse.
- 3.3** Palët angazhohen për mbështetje në krijimin e rregullave dhe praktikave më të mira për realizimin e trajnimeve të vazhdueshme të detyrueshme dhe menaxhim të regjistrave për pjesëmarrësit e trajnimeve.


Neni 4
Kohëzgjatja e Memorandumit

- 4.1** Ky MiM nënshkruhet për periudhën 1 (një) vjeçare, me mundësi vazhdimi.
- 4.2** Në rast se asnjëra nga palët nënshkruese nuk e paralajmëron shkëputjen e këtij MiM një muaj para përfundimit të tij, MiM konsiderohet të jetë vazduar me automatizëm.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga palët.


Në pajtim të plotë, palët e nënshkruajnë këtë Memorandum të Mirëkuptimit më 17 tetor 2012.



Instituti Gjyqësor i Kosovës
Lavdim Krasniqi
Drejtør



Instituti Gjyqësor i Kosovës
Fejzullah Hasan
Kryesues i Bordit



Oda e Avokatëve të Kosovës
Ibrahim Dobruna
Kryetar

MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT

1. Komisioni për Ndihmë Juridike (KNJ),

dhe

2. Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK)

Për ofrimin e ndihmës juridike

Hyrje:

Sipas nenit 7 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/36 për Ndihmë Juridike, Komisioni i Ndihmës Juridike (KNJ) është i autorizuar të bashkëpunojë me Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK), me qëllim që të siguroj cilësinë e shërbimeve juridike të ofruara në sistemin e ndihmës juridike, si dhe përfaqësimin të drejtë të grupeve të cenueshme në mesin e përfituesve dhe ofruesve të ndihmës juridike etj.

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i këtij dokumenti është që të definohen qartë caqet, objektivat dhe përgjegjësitetë përkatëse të secilit organ veç e veç. Palët e Marrëveshjes formalisht pajtohen që të bashkëpunojnë në pajtim me nenin 7 të Rregullores për Ndihmë Juridike 2006/36.

Qëllimi i bashkëpunimit dhe objektiva

Qëllimi i bashkëpunimit është përkrahja për qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët e Kosovës të cilëve i është mohuar kjo e drejtë për shkak të mungesës së mjeteve materiale, nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike falas.

1. Palët e Marrëveshjes

Palët e kësaj Marrëveshjeje janë Komisioni për ndihmë juridike (në tekstin e mëtejmë e referuar si KNJ) dhe Odës së Avokatëve të Kosovës (në tekstin e mëtejmë e referuar si OAK).

KNJ dhe OAK pajtohen se do të bashkëpunojnë për të përbashkëta dhe përgjegjësin e ndërsjellët, duke e mbajtur identitetin e tyre veçues.

2. Vlerat e Bashkëpunimit

- 2.1. Vaprojnjë në kuadër të mandatit që kanë.
- 2.2. Promovojnë tolerancën dhe mirëkuptimin.
- 2.3. Bashkëpunojnë në përcaktimin e veprimeve, për të siguruar përfaqësimin e drejtë të përfituesve të ndihmës juridike.
- 2.4. Definojnë reciprokisht të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë Marrëveshje
- 2.5. Ndajnë përgjegjësitë në identifikimin e nevojave dhe mundësive prioritare, të përfituesve të ndihmës juridike.
- 2.6. Zhvillojnë një plan afat-mesëm me qëllim të qëndrueshmërisë së ofrimit të ndihmës juridike.

3. Parimet e Bashkëpunimit

- 3.1. Bashkëpunimi do të udhëhiqet nga parimet vepruese të KNJ dhe OAK të cilat mbështeten në kapacitetet plotësuese të të dy organeve, për të arritur misionin e ofrimit falas të ndihmës juridike për njerëz të varfér dhe të margjinalizuar.

Në pajtim me këto parime KNJ dhe OAK do të :

- 3.2. Bashkëpunojnë ne krijimin e një mekanizmi/trupi të përbashkët koordinues me qellim te koordinimit sa më efektiv të aktiviteteve në ofrimin e ndihmës juridike.
- 3.3. Trupi i përbashkët koordinues do të jetë përgjegjës për koordinimin e bashkëpunimit në nivel qendror dhe atë rajonal.
- 3.4. Trupi i përbashkët koordinues do të drejtohet nga Komisioneri i Ndihmës Juridike dhe Kryetari OAK të cilët do te koordinojnë aktivitetet në nivel të politikave .
- 3.5. Koordinatori i KNJ dhe pala bashkëpunuese nga OAK të koordinojnë aktivitetet funksionale dhe menaxheriale .
- 3.6. Udhëheqësit e byrove rajonale të KNJ dhe udhëheqësit e odave rajonale do të koordinojnë në nivelin e tyre punën e tyre ditore me qëllim të ofrimit sa më efikas dhe cilësor të ndihmës juridike.
- 3.7. Pas konstituimit të këtij trupi do të përcaktohen në mënyrë të detajuar kushtet e bashkëpunimit dhe përshkrimi i punëve.

3.8. Konform nenit 8.2. të Rregullores për Ndihmë Juridike, lidhin kotratë me anëtarët e OAK, respektivisht me avokatët të disponuar nga regjistrat e BQNJ-ve.

4. Përgjegjësitë e OAK-së

- 4.1. Përfaqësimin në gjykata, e ushtrojnë ekskluzivisht anëtarët e Odës së Avokatëve të Kosovës.
- 4.2. Oda e Avokatëve të Kosovës, përgatit listat e avokatëve të disponueshëm për ofrimin e ndihmës juridike, për çdo qark veç veç.
- 4.3. OAK i'a dorëzon listat e avokatëve Zyrës Koordinuese cdo 3 (tre) muaj, në mënyrë që të sigurohen shërbimet për kërkuesit e ndihmës juridike falas në vazhdimësi.
- 4.4. OAK duhet të inkurajoj ofrimin e ndihmës juridike në baza vullnetare (pro bono) grupeve të ndjeshme.
- 4.5. OAK obligohet që të informoj Komisionin për të gjitha vërejtjet e ushtruara kundër anëtarëve të saj, që gjenden në regjistrat e qarkut për ofrimin e ndihmës juridike.
- 4.6. OAK obligohet që të siguroj përfaqësim të rregullt në trupin e përbashkët bashkërendues në nivel qendror dhe atë rajonal.

5. Përgjegjësit e KNJ-së

- 5.1. KNJ përpilon tarifën për kompensimin e punës së avokatëve në bazë të pikave dhe cakton vlerën e një pike.
- 5.2. KNJ obligohet, që për shërbimet e ofrimit të ndihmës juridike, avokatëve te ua kompensoj mjetet materiale, në lartësinë e shumës së caktuar me tarifën e KNJ-së.
- 5.3. KNJ përpilon formularin për caktimin e avokatit kujdestar.
- 5.4. KNJ shqyrtion dhe zgjidhë problemet etike në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike dhe sipas nevojës këto çështje ia referon Odës së Avokatëve.
- 5.5. KNJ pas informimit të OAK-së, suspendon apo largon avokatët nga lista për shërbimet e ndihmës juridike, të cilët nuk i janë përmbajtur dispozitave të Rregullores nr. 2006/36, ose aktit nënligjor të miratuar në pajtim me këtë Rregullore.

- 5.6. KNJ lidhë kontratë me avokatët e OAK-së, të angazhuar për ofrimin e ndihmës juridike në çdo rast veç e veç.
- 5.7. KNJ obligohet që të siguroj përfaqësim të rregullt në trupin e përbashkët koordinues në nivel qendror dhe atë rajonal

6. Modifikimi i qëllimeve dhe objektivave

- 6.1. Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje, mund të bëhet me pajtim reciprok

7. Menaxhimi

- 7.1. KNJ do të jetë përgjegjëse për menaxhimin ditor të bashkëpunimit, përderisa OAK do të siguroj përfaqësim të rregullt në trupin e përbashkët bashkërendues dhe ofrimin e ndihmës juridike sipas kërkesës së KNJ.
- 7.2. Palët do të shkëmbjnë të gjitha informatat të cilat janë të domosdoshme për të arritur objektivat e bashkëpunimit dhe për ti dokumentuar të njëjtat.
- 7.3. Informatat konfidenciale nuk do të këmbehen me asnjë person apo organizatë nga jashtë, pa pajtimin e palëve.

8. Nënshkrimet

- 8.1. Kjo marrëveshje është bërë në frysë të besimit, bashkëpunimit në përfitim të të gjitha palëve.



Z. Sokol Hazri
Komisioner i KNJ



Z. Musa Dragusha
Kryetar i OAK